



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0466

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Nexhmije X. Veseli, kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit të KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me dru dhe pelet me numër të prokurimit 632-26-3785-1-1-1, me 14/08/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërishte e bazuar ankesa e Nexhmije X. Veseli me nr. 2026/0466, e datës 06/07/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru dhe pelet”, me numër të prokurimit 632-26-3785-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS.

2. Mbetet në fuqi, Korigjimi i procedurës (B54) i datës 26.06.2026 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru dhe pelet”, me numër të prokurimit 632-26-3785-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, dhe 6 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 4, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.05.2026 – KOMUNA E GJAKOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur “Furnizim me dru dhe pelet” me nr. të prokurimit: "632-26-3785-1-1-1",

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 200,000.00 € €.

Me 25.06.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 26.06.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 06.07.2026, OE “Nexhmije X. Veseli”B.I- apo N.T.SH. OKTA ING ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0466, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder njoftimit të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues ““Nexhmije X. Veseli”B.I- apo N.T.SH. OKTA ING. janë parashtruar si në vijim:

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti KontraktuesPRETENDIMI NR. 1

Shkelja e nenit 7, nenit 27, nenit 53, nenit 68 dhe nenit 69 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, si dhe nenit 17.7 dhe nenit 25.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, për shkak se Autoriteti Kontraktues, edhe pse e ka aprovuar si të bazuar Kërkesën për Rishqyrtim, nuk e ka eliminuar kriterin kufizues, por vetëm e ka zëvendësuar atë me një kriter tjetër po ashtu kufizues.

Autoriteti Kontraktues, me vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim, ka aprovuar si të bazuar kërkesën e Operatorit Ekonomik ankues dhe ka vendosur korrigjimin e Dosjes së Tenderit dhe të Njoftimit për Kontratë. Megjithatë, ndryshimet e bëra nuk kanë eliminuar shkeljen e evidentuar, por vetëm kanë zëvendësuar kriterin fillestar me një kriter tjetër, i cili vazhdon të kufizojë konkurrencën dhe të imponojë kushte që nuk rezultojnë të jenë të domosdoshme për realizimin e kontratës.

Fillimisht, Dosja e Tenderit kërkonte që operatorët ekonomikë të dispononin tre (3) kamionë me kapacitet bartës minimal prej 10 tonësh. Pas aprovimit të Kërkesës për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues e ndryshoi këtë kriter duke kërkuar një (1) kamion me kapacitet bartës maksimal deri në 7 ton dhe dy (2) kamionë me kapacitet bartës maksimal deri në 5 ton.

Edhe pse forma e kriterit është ndryshuar, thelbi i tij ka mbetur i njëjtë. Autoriteti Kontraktues vazhdon të imponojë kufizime mbi peshën bartëse të mjeteve transportuese, pa paraqitur asnjë analizë teknike, profesionale apo ekonomike që dëshmon se një kufizim i tillë është i domosdoshëm dhe proporcional me objektin e kontratës.

Në vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim se përse kriteri fillestar prej 10 tonësh është konsideruar i papërshtatshëm, ndërsa kriteri i ri prej 7 tonësh dhe 5 tonësh konsiderohet i ligjshëm dhe proporcional. Mungon çdo analizë që do të justifikonte zgjedhjen e këtyre kufijve të tonazhit dhe lidhjen e tyre me nevojat reale të kontratës.

Për më tepër, ndryshimi i bërë tregon se vetë Autoriteti Kontraktues ka pranuar se kriteri fillestar nuk ishte i qëndrueshëm. Megjithatë, në vend që ta eliminojë plotësisht kufizimin dhe të kërkojë vetëm disponimin e mjeteve transportuese të përshtatshme për realizimin e kontratës, ai ka vendosur kufij të rinj të tonazhit, të cilët vazhdojnë të kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë pa një bazë objektive dhe të arsyetuar.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, nenin 27, nenin 53, nenin 68 dhe nenin 69 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, si dhe me nenin 17.7 dhe nenin 25.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, pasi edhe pas korrigjimit të Dosjes së Tenderit ka ruajtur një kriter që vazhdon të kufizojë konkurrencën pa një arsyetim teknik dhe juridik të mjaftueshëm.

PRETENDIMI NR. 2

Shkelja e nenit 7, nenit 27, nenit 68 dhe nenit 69 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, si dhe nenit 17.7 dhe nenit 25.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, për shkak të mungesës së proporcionalitetit dhe lidhjes së drejtpërdrejtë ndërmjet kriterit të peshës bartëse të mjeteve transportuese dhe objektit të kontratës.

Autoriteti Kontraktues, edhe pas korrigjimit të Dosjes së Tenderit, ka vazhduar të kërkojë që operatorët ekonomikë të disponojnë mjete transportuese me peshë bartëse të përcaktuar, pa paraqitur asnjë arsyetim teknik, funksional apo profesional që dëshmon se një kërkesë e tillë është e domosdoshme për realizimin e kontratës.

Objekti i kontratës është furnizimi me dru dhe pelet, ndërsa qëllimi i kërkesave për aftësinë teknike duhet të jetë verifikimi nëse operatori ekonomik disponon kapacitete të mjaftueshme për realizimin e kontratës. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka shpjeguar përse realizimi i kësaj kontrate mund të bëhet vetëm me mjete transportuese që plotësojnë kufijtë e përcaktuar të peshës bartëse.

Nga vendimi mbi Kërkesën për Rishqyrtim dhe nga dokumentacioni i procedurës nuk rezulton të jetë kryer ndonjë analizë mbi rrjetin rrugor, qasjen në lokacionet e furnizimit, kushtet infrastrukturore, mënyrën e shkarkimit të mallit apo ndonjë element tjetër teknik që do të justifikonte vendosjen e kufijve të caktuar të tonazhit.

Përcaktimi i peshës bartëse të mjeteve transportuese, pa një analizë objektive dhe të dokumentuar, nuk dëshmon aftësinë teknike të operatorit ekonomik, por kufizon mënyrën se si operatori ekonomik organizon realizimin e kontratës, duke kufizuar pa nevojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që disponojnë mjete të tjera transporti të përshtatshme për realizimin e kontratës.

Për rrjedhojë, kriteri i vendosur nuk plotëson kërkesën ligjore të proporcionalitetit dhe të lidhjes së drejtpërdrejtë me objektin e kontratës, duke qenë në kundërshtim me nenin 7, nenin 27, nenin 68 dhe nenin 69 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, si dhe me nenin 17.7 dhe nenin 25.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

PRETENDIMI NR. 3

Shkelja e nenit 68 dhe nenit 69 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, si dhe nenit 25.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, për shkak se kriteri i peshës bartëse të mjeteve

transportuese nuk përbën kriter të vlefshëm për vlerësimin e aftësisë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë.

Sipas nenit 68 dhe nenit 69 të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë dëshmi që vërtetojnë aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, mirëpo këto kërkesa duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe të kufizohen vetëm në atë që është e nevojshme për të vlerësuar aftësinë reale të operatorit ekonomik për realizimin e saj.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si kriter kualifikues peshën bartëse të mjeteve transportuese, duke përcaktuar kufij të caktuar të tonazhit. Megjithatë, pesha bartëse e një kamioni, në vetvete, nuk dëshmon aftësinë teknike apo profesionale të operatorit ekonomik, por përfaqëson vetëm një karakteristikë teknike të një mjeteve transporti.

Aftësia teknike e operatorit ekonomik duhet të vlerësohet nëse ai disponon mjete transporti të përshtatshme, të regjistruara dhe funksionale, të cilat mundësojnë realizimin e kontratës në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues. Ligji nuk e lidh aftësinë teknike të operatorit ekonomik me posedimin e mjeteve transportuese me një peshë bartëse të paracaktuar, përveç rasteve kur një kërkesë e tillë mbështetet në analiza konkrete dhe objektive, të cilat në këtë procedurë nuk janë paraqitur.

Vendosja e kufijve të tonazhit nuk vlerëson aftësinë e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën, por kufizon artificialisht numrin e operatorëve ekonomikë që mund të marrin pjesë në procedurë, edhe pse ata mund të disponojnë kapacitete të mjaftueshme për realizimin e plotë dhe në kohë të kontratës.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar se përse një operator ekonomik që disponon mjete të tjera transportuese, të përshtatshme për transportin e druve dhe peletit, nuk do të ishte në gjendje të realizonte kontratën në përputhje me kërkesat kontraktuale.

Për rrjedhojë, kriteri i kontestuar nuk përbën kriter të ligjshëm për vlerësimin e aftësisë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë dhe është në kundërshtim me nenin 68 dhe nenin 69 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, si dhe me nenin 25.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

PRETENDIMI NR. 4

Shkelja e nenit 7, nenit 27 dhe nenit 53 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, për shkak të mungesës së arsytimit faktik dhe juridik në Vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim lidhur me domosdoshmërinë e kriterit të kontestuar.

Autoriteti Kontraktues, me Vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim, ka aprovuar si të bazuar kërkesën e Operatorit Ekonomik ankues dhe ka vendosur korrigjimin e Dosjes së Tenderit. Megjithatë, në vendim nuk ka dhënë asnjë arsyetim faktik apo juridik që justifikon kriterin e ri të vendosur lidhur me peshën bartëse të mjeteve transportuese.

Nga përmbajtja e vendimit nuk rezulton se Autoriteti Kontraktues ka kryer ndonjë analizë teknike, operative apo ekonomike mbi bazën e së cilës ka arritur në përfundimin se kufijtë e rinj të tonazhit janë të domosdoshëm për realizimin e kontratës.

Po ashtu, nuk rezulton të jetë analizuar:

nevoja reale për vendosjen e kufijve të caktuar të peshës bartëse; ndikimi i këtij kriteri në konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; proporcionaliteti i kriterit në raport me objektin e kontratës; arsyet pse kriteri fillestar është zëvendësuar pikërisht me kufijtë e rinj të tonazhit.

Vendimi i Autoritetit Kontraktues kufizohet vetëm në ndryshimin e kërkesës, pa shpjeguar mbi cilat fakte, analiza apo dispozita ligjore është mbështetur për të arritur në këtë përfundim.

Një vendim administrativ që ndryshon kushtet e një procedure të prokurimit duhet të jetë i arsyetuar në mënyrë të plotë, në mënyrë që operatorët ekonomikë dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit të kenë mundësi të verifikojnë ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e kriterit të vendosur.

Në mungesë të një arsyetimi të tillë, është e pamundur të konstatohet nëse ndryshimi i bërë nga Autoriteti Kontraktues është rezultat i një vlerësimi objektiv dhe profesional apo thjesht i një ndryshimi formal që nuk eliminon kufizimin e konkurrencës.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se Vendimi mbi Kërkesën për Rishqyrtim nuk përmban arsyetimin e nevojshëm faktik dhe juridik që do të justifikonte ligjshmërinë e kriterit të ri të vendosur, duke vepruar në kundërshtim me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, të garantuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

Duke pasur parasysh se objekti i kësaj ankese lidhet me ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e një kriteri kualifikues të vendosur në Dosjen e Tenderit, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që gjatë shqyrtimit të kësaj ankese të vlerësojë nëse Autoriteti Kontraktues ka paraqitur ndonjë analizë teknike, funksionale ose juridike që justifikon vendosjen e kufijve të caktuar të peshës bartëse të mjeteve transportuese dhe nëse një kriter i tillë është proporcional dhe i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 001/2022.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet, deri në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Nenin 1 të LPP-së, pasi nuk siguron përdorimin më efikas të fondeve publike dhe kufizon konkurrencën.

Nenin 7, paragrafët 1, 2, 3 dhe 6 të LPP-së, pasi nuk siguron trajtim të barabartë dhe pjesëmarrje sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë.

Nenin 27 të LPP-së, pasi Dosja e Tenderit duhet të përgatitet në mënyrë që kërkesat të jenë të lidhura me objektin e kontratës dhe të mos vendosin kufizime të panevojshme.

Nenin 17.7 të Rregullores Nr. 001/2022, i cili përcakton se Dosja e Tenderit nuk duhet të kufizojë konkurrencën ose të favorizojë një ose më shumë operatorë ekonomikë.

Nenin 25.4 të Rregullores Nr. 001/2022, sipas të cilit kërkesat minimale të kualifikimit duhet të formulohen në mënyrë që të mos përjashtojnë operatorët ekonomikë që posedojnë kapacitete të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Data e Njoftimit për Kontratë: 21.05.2026, kurse data e planifikuar e hapjes së ofertave ka qenë e parashikuar të bëhet më 01.07.2026, në ora 13:30.

Ne, pasi kemi analizuar Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, kemi ardhur në përfundim se në Dosjen e Tenderit janë vendosur kërkesa diskriminuese dhe të cilat realisht kufizojnë konkurrencën, ndërsa mund të shpijnë në favorizim të ndonjë kompanie. Andaj, më poshtë i gjeni pretendimet tona ankimore:

Në Dosjen e Tenderit, tek Kapaciteti Teknik dhe Profesional, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar:

"Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për 3 (tre) kamionë me peshë ngarkuese minimum 10 ton..."

Kërkesa e lartcekur është diskriminuese, joproporcionale dhe kufizon konkurrencën, pasi që Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim teknik apo profesional se përse realizimi i kësaj kontrate kërkon domosdoshmërisht posedimin e tre kamionëve me peshë ngarkuese minimale prej 10 ton.

Objekti i këtij aktiviteti të prokurimit është furnizimi me dru dhe pelet në shkollat e Komunës së Gjakovës. Në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit nuk është argumentuar se furnizimi nuk mund të realizohet me automjete transportuese me kapacitet më të vogël.

Përkundrazi, furnizimi mund të realizohet në mënyrë të plotë dhe efikase edhe me kamionë me kapacitet 5 ton, 6 ton apo 7.5 ton, qoftë edhe përmes një numri më të madh transportesh, pa ndikuar në cilësinë, afatin apo përmbushjen e kontratës.

Për më tepër, vendi i furnizimit janë shkollat e Komunës së Gjakovës, të cilat ndodhen kryesisht në zona urbane, ku në shumë raste qarkullimi i automjeteve të rënda është i kufizuar, ndërsa qasja në oborret e shkollave është më e përshtatshme me automjete me tonazh më të vogël.

Autoriteti Kontraktues nuk ka argumentuar në asnjë mënyrë se përse një operator ekonomik që posedon tre kamionë me kapacitet më të vogël nuk është i aftë ta realizojë kontratën.

Pesha e kamionit nuk përbën kriter që dëshmon aftësinë teknike apo profesionale të operatorit ekonomik, por është vetëm karakteristikë teknike e mjetit transportues. Për këtë arsye, vendosja e kufirit minimal prej 10 ton nuk është e lidhur me objektin e kontratës dhe nuk është kriter i domosdoshëm për realizimin e saj.

Kjo kërkesë favorizon vetëm operatorët ekonomikë që posedojnë automjete të këtij tonazhi, ndërsa përjashton operatorë të tjerë ekonomikë të cilët posedojnë mjete transportuese të përshtatshme dhe kanë kapacitet të plotë për realizimin e kontratës.

Prandaj, kërkesa e lartcekur bie në kundërshtim me nenin 1 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton se qëllimi i ligjit është të sigurojë përdorimin sa më efikas, transparent dhe ekonomik të fondeve publike.

Gjithashtu, kjo kërkesë bie në kundërshtim me nenin 7, paragrafët 1, 2, 3 dhe 6 të LPP-së, pasi nuk siguron trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë, diskriminon operatorët që posedojnë mjete të përshtatshme transportuese dhe kufizon pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë.

Po ashtu, kërkesa nuk është në harmoni me nenin 27 të LPP-së, pasi Dosja e Tenderit duhet të përgatitet në mënyrë që kriteret e kualifikimit të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës, e jo të vendosen kufizime që nuk ndikojnë në realizimin e saj.

Kjo kërkesë bie gjithashtu në kundërshtim me nenin 17.7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, ku përcaktohet qartë se Dosja e Tenderit nuk duhet të kufizojë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe nuk duhet të diskriminojë apo favorizojë një ose më shumë operatorë ekonomikë.

Njëkohësisht, kërkesa bie në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, sipas të cilit Autoriteti Kontraktues, gjatë përcaktimit të kërkesave minimale të kualifikimit, duhet ti formulojë ato në mënyrë që të mos përjashtojë operatorët ekonomikë që posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike për realizimin e kontratës.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e lartcekura, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që kjo kërkesë të ndryshohet dhe të zëvendësohet me një kriter proporcional, duke kërkuar vetëm mjete transportuese të përshtatshme për realizimin e kontratës, pa përcaktuar tonazh minimal prej 10 ton për secilin kamion.

Në të kundërtën, kjo kërkesë vazhdon të mbetet diskriminuese, kufizon konkurrencën dhe favorizon operatorë ekonomikë të caktuar, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores për Prokurimin Publik.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14.07.2026. ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0466 ndërsa me datë 20.07.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0466, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores

së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e “Nexhmije X. Veseli”B.I- apo N.T.SH. OKTA ING eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0460 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues ka bashkuar përgjigjet në pretendimet ankimore 1, 2, 3 dhe 4, pasi të gjitha pretendimet lidhen me kriterin si në vijim:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete – pajisje teknike për realizimin e kontratës, siç janë 1 kamion me peshë ngarkuese maksimum 7 t dhe 2 kamionë me peshë ngarkuese maksimum 5 t.

Objekt i kësaj ekspertize është vlerësimi i kriterit të përcaktuar në Dosjen e Tenderit, sipas të cilit operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon ose ka kontratë qiraje për:

1 kamion me peshë ngarkuese maksimum 7 ton; dhe

2 kamionë me peshë ngarkuese maksimum 5 ton.

Parimet themelore të prokurimit publik kërkojnë që kriteret e kualifikimit të jenë:

të lidhura me objektin e kontratës;

proporcionale me nevojat reale të Autoritetit Kontraktues;

të mos krijojnë kufizime të panevojshme të konkurrencës.

Në rastin konkret, objekti i kontratës është furnizimi me dru dhe pelet. Për realizimin e këtij aktiviteti është e rëndësishme që operatori ekonomik të disponojë mjete transporti të përshtatshme dhe me kapacitet të mjaftueshëm për shpërndarjen e mallrave.

Megjithatë, përcaktimi i një peshe maksimale të mjeteve (7 ton dhe 5 ton) nuk paraqet një kërkesë që lidhet drejtpërdrejt me aftësinë profesionale ose teknike të operatorit ekonomik. Përkundrazi, kjo kërkesë përjashton operatorët që disponojnë mjete me kapacitet më të madh, të cilat janë plotësisht të afta për realizimin e kontratës.

Në aspektin teknik, një kamion me kapacitet më të madh mund të kryejë të njëjtin transport ose edhe më shumë, pa ndikuar negativisht në cilësinë e furnizimit. Për këtë arsye, kufizimi me peshë maksimale nuk paraqet një kriter të domosdoshëm për realizimin e kontratës.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur ndonjë arsyetim teknik që do ta justifikonte këtë kufizim, siç mund të ishin:

kufizimet infrastrukturore të rrugëve;

kufizimet e urave;

pamundësia e qasjes së mjeteve më të mëdha në lokacionet e furnizimit;

kufizimet ligjore për qarkullimin e mjeteve.

Në mungesë të një arsytimi të tillë, kërkesa nuk konsiderohet proporcionale.

Gjithashtu, kërkesa për një numër fiks prej tre kamionësh duhet të mbështetet në analiza të vëllimit të furnizimeve dhe afateve të ekzekutimit. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk demonstroi se realizimi i kontratës është i pamundur me një organizim tjetër të transportit, atëherë edhe kjo kërkesë paraqet një kufizim të panevojshëm të konkurrencës.

Nga analiza teknike dhe juridike rezulton se kriteri që operatori ekonomik duhet të disponojë një kamion me peshë ngarkuese maksimum 7 ton dhe dy kamionë me peshë ngarkuese maksimum 5 ton nuk është proporcional me objektin e kontratës për furnizim me dru dhe pelet.

Ky kriter kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që disponojnë mjete me kapacitet më të madh, edhe pse këto mjete janë teknikisht të afta për realizimin e kontratës. Në mungesë të një arsytimi objektiv dhe teknik nga Autoriteti Kontraktues, kriteri krijon pengesa të panevojshme për konkurrencën dhe mund të konsiderohet diskriminues, pasi nuk respekton parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës efektive në procedurat e prokurimit publik.

Eksperti shqyrtues rekomandon që ky kriter të riformulohet duke kërkuar mjete transporti me kapacitet të përshtatshëm për realizimin e kontratës, pa vendosur kufizime të pajustificuara lidhur me peshën maksimale të tyre, përveç rasteve kur këto kufizime mbështeten në arsye objektive dhe të dokumentuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i caktuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, ku kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkëlqeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyr të pavarur dhe objektive administroj të gjitha shkresat e lëndës përfshirë pretendimet ankimore të OE ankues, dhe në këtë rastën eksperti shqyrtues në raportin e

tije ka dështuar të ofronte argumente të çarta , ku OE ankues pretendimet ankimore i ka pasur kryesisht me kapacitetin e tonazhes per kamion prej maksimum per peshën bartëse 10 ton, ku e ka konsideruar qe nje tonazh e tille për rrugën urbane ne shkollat per çka është inicuar ky aktivitet është tonazh e larte (10 t) ndërsa eksperti ne raportin e tije ka cituar ‘ *Nga analiza teknike dhe juridike rezulton se kriteri që operatori ekonomik duhet të disponojë një kamion me peshë ngarkuese maksimum 7 ton dhe dy kamionë me peshë ngarkuese maksimum 5 ton nuk është proporcional me objektin e kontratës për furnizim me dru dhe pelet. Ky kriter kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që disponojnë mjete me kapacitet më të madh, edhe pse këto mjete janë teknikisht të afta për realizimin e kontratës, kështu duke ofruar opinion per ata te cilët kanë kamionë me tonazh me te larte ku tonazha e kërkuar nga AK-ja eshte maksimale. Paneli Shqyrtues analizoj kerkesën per rishqyrtim (data 24.06.2026) , ku pretendimet ankimore ishin të ndryshme ne kerkes për rishqyrtim eshte kërkuar te ndryshohet dosja duke e larguar ose ndryshuar kërkesën kështu duke deklaruar se edhe me kamion me kapacitet 5 ton, 6 ton apo 7.5 ton mund te realizohet ,ndërsa ne ankes ka kërkuar të kërkojë vetëm disponimin e mjeteve transportuese të përshtatshme për realizimin e kontratës.*

ku ne kerkes per rishqyrtim ka kërkuar citoj ‘ *që Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsytim teknik apo profesional se përse realizimi i kësaj kontrate kërkon domosdoshmërisht posedimin e tre kamionëve me peshë ngarkuese minimale prej 10 ton. Objekti i këtij aktiviteti të prokurimit është furnizimi me dru dhe pelet në shkollat e Komunës së Gjakovës. Në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit nuk është argumentuar se furnizimi nuk mund të realizohet me automjete transportuese me kapacitet më të vogël. Përkundrazi, furnizimi mund të realizohet në mënyrë të plotë dhe efikase edhe me kamionë me kapacitet 5 ton, 6 ton apo 7.5 ton, qoftë edhe përmes një numri më të madh transportesh, pa ndikuar në cilësinë, afatin apo përmbushjen e kontratës. Për më tepër, vendi i furnizimit janë shkollat e Komunës së Gjakovës, të cilat ndodhen kryesisht në zona urbane, ku në shumë raste qarkullimi i automjeteve të rënda është i kufizuar, ndërsa qasja në oborret e shkollave është më e përshtatshme me automjete me tonazh më të vogël, ku Autoriteti Kontraktues nuk ka argumentuar në asnjë mënyrë se përse një operator ekonomik që posedon tre kamionë me kapacitet më të vogël nuk është i aftë ta realizojë kontratën. Pështja e kamionit nuk përbën kriter që dëshmon aftësinë teknike apo profesionale të operatorit ekonomik, por është vetëm karakteristikë teknike e mjetit transportues. Për këtë arsye, vendosja e kufirit minimal prej 10 ton nuk është e lidhur me objektin e kontratës dhe nuk është kriter i domosdoshëm për realizimin e saj KËSHTU DUKE KERKUAR TE NDRYSHOHET Dosja e Tenderit duke larguar ose ndryshuar kërkesën që obligon operatorët ekonomikë të posedojnë 3 (tre) kamionë me peshë ngarkuese minimale 10 ton, pasi e njëjta është joproporcionale, kufizon konkurrencën dhe është në kundërshtim me nenin 1, nenin 7 dhe nenin 27 të LPP-së, si dhe nenin 17.7 dhe nenin 25.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. .*

AK ja duke aprovuar Kërkesen për rishqyrtim sipas datës 26.06.2026, ka korrigjuar procedurën me datën 26.06.2026 permes formularit per korigjimin e procedures (B54) duke ndryshuar kerkesën ku nga tri kamion me kapacitetin prej min 10 t peshe ngarkuese ka zbritur citoj ‘ *1 kamionë me peshe ngarkuese maksimum 7 t dhe 2 kamiona me peshe ngarkuese maksimum 5 t. Ndersa eksperti shqyrtues nuk ka analizuar fare kërkesën per rishqyrtim të OE ankues , aprovimin nga AK-ja dhe korigjimine procedurës , ku ne raport ka deklaruar se ‘Ky kriter kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që disponojnë mjete me kapacitet më të madh’, e që nje konstatim i tille bje ndesh me pretendimet ankimore të OE ankues ku dhe vet OE ankues i cili ka deklaruar citoj *ku në shumë raste qarkullimi i automjeteve të rënda është i kufizuar*’, ku në shumë raste qarkullimi i automjeteve të rënda është i kufizuar, ndërsa qasja në*

oborret e shkollave është më e përshtatshme me automjete me tonazh më të vogël, kështu duke rekomanduar edhe korigjimin e procedurës dhe zgjatjen e afatit duke ja aprovuar ankesën e OE e në anën tjetër duke cituar se kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që disponojnë mjete me kapacitet më të madh, e që për PSH konstatimet të tilla dhe kontradikte janë jo profesionale ku OE ankues fillimisht ka kërkuar hjekjen e tonazhes së bartjes prej minimum 10t, ndërsa eksperti përveq se e aprovon ankesën e OE në raportin e tij citon se *'Ky kriter kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që disponojnë mjete me kapacitet më të madh'* e që bijnë ndesh edhe me pretendimet ankimore të OE ankuesit si dhe tejkalon autorizimet ligjore sikurse parashihen në nenin 113 dhe 114 të LPP-se.

Poashtu, Paneli Shqyrtues konsideron se AK sipas kërkesës së vet OE ankues i cili ka deklaruar se edhe me kamionë me kapacitet 5 ton, 6 ton apo 7.5 ton furnizimi mund të realizohet AK ka zbritur në maksimum 7 ton dhe dy kamion në maksimal 5 ton, për çka ju mundësohet të ofertojnë edhe kamion për bartje me peshë më pak se 7 tone apo 5 ton nën maksimumin e kërkuar. Dhe në rastet e mungesës së paisjeve OE të interesuar mund të lidhin marrëveshje për shfrytëzim (me qera), kur dihet që kjo procedurë është kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 10 muajsh, ku janë kërkuar 560 ton pelet dhe dru: 192 m³, dhe është e domosdoshme që secili OE i cili shpreh interesim për të ofertuar duhet të ketë në dispozicion paisjet si në rastin konkret kamion për bartje e që është i domosdoshëm për realizim të kontratës. Megjithatë, Paneli e obligon AK-në që në rastet se pranohen ofertat gjatë vlerësimit të ofertave këtë kriter ta zbatojë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese. Konkretisht, dallimi ndërmjet kapaciteteve të ofruara si shembull p.sh. është ofruar 3 ton dhe tjetri 4.5 ton, duke u thirrur në atë në maksimum 5 tone, nuk mund të përdoret si bazë për krijimin e një metode të re vlerësimi apo për favorizimin e një oferte, nëse një metodë e tillë nuk është përcaktuar paraprakisht në dokumentet e tenderit dhe nuk mund të shtojë kritere apo mënyra të reja gjatë shqyrtimit të ofertave.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues bazuar nga gjithë të gjeturat në këtë procedurë e aprovon pjesërisht ankesën e OE ankues sa i përket maksimumit të vendosur, mirpo ka vendosur ta mbështet Njoftimin për kontratë, konkretisht Korigjimi i procedurës (B54) i datës 26.06.2026 lidhur me procedurën me titull "Furnizim me dru dhe pelet", me nr 632-26-3785-1-1-1-të iniciuar nga AK-ja Komuna e Gjakovës, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë procedurë.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E GJAKOVËS**
- OE - **Nexhmije X. Veseli**
- Arkivës së OSHP-së: